



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Mbledhje e përbashkët

*Këshilli për Legjislacionin dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike
dhe të Drejtat e Njeriut*

PROCESVERBAL

Elbasan, më 15.11.2018, ora 10:00

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me pedagogë dhe studentë të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”,
Elbasan

Marrin pjesë:

Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Bledar Çuçi, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Ermonela Felaj, Klodiana Spahiu, Elena Xhina, Jurgis Çyrbja, Xhemal Qefalia, Luçiano Boçi, Edmond Leka.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Bashkim Fino, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Tom Doshi, Silva Caka, Edmond Haxhinasto.

HAPET MBLEDHJA

Skënder Topi – Mirë se erdhët, profesorë dhe studentë!

Takimi i sotëm është takimi i parë, i cili realizohet në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit për fuqizimin e parlamentarizmit dhe rritjen e kontributit të 4 Miqve në procesin ligjvënës. Institucionalizimi i këtij bashkëpunimi është i rëndësishëm për tri arsye kryesore:

Së pari, akademikët e Universitetit të Elbasanit angazhohen në cilësinë e ekspertëve të ndryshëm në lidhje me asistencën tekniko-akademike, oponencën ligjore apo draftimin e projektligjeve të ndryshme në Kuvend, duke kontribuar për një vendimmarrje më të mirë.

Së dyti, stafit akademik i Universitetit të Elbasanit i mundësohet akses dhe hulumtim në bibliotekën e pasur të Kuvendit, për të cilën, zonja Hysi, në një takim që ne kishim me Kryetarin e Kuvendit, zotin Gramoz Ruçi, ku ishin të pranishëm të gjithë rektorët, e cilëson si një thesar, duke mundësuar realizimin e projekteve kërkimore dhe shkencore që strukturat tona, stafi akademik dhe studentët t'i kenë në dispozicion.

Së treti, ofron mundësi reale, pozitive e mbështetëse për studentët në lidhje me zhvillimin e praktikave të tyre apo kërkimin drejt zhvillimit të temave të diplomave si në nivelin Bachelor, Master dhe Doktoraturë.

Bashkëpunimi midis dy institucioneve tona krijon një mekanizëm këshillimor, sepse Kuvendi është i pavarur në veprimtarinë e tij, por në çdo rast ky mekanizëm është në nivelin më të lartë të ekspertizës dhe mbi të gjitha larg subjektivizmit politik.

Gjithashtu, Universiteti i Elbasanit gëzon një status të veçantë, kjo për arsye se stafi akademik i këtij universiteti sot është pjesë juaja në cilësinë e deputetëve, të organeve të pavarura kushtetuese apo të këshillave dhe komisioneve të posaçme. Në cilësinë e rektorit, e kam pranuar dhe do ta pranoj me kënaqësi, çdo nismë apo iniciativë, e cila sjell mundësi të reja dhe krijon bashkëpunime të frytshme.

Sot, Universiteti i Elbasanit përfaqëson një institucion të arsimit të lartë, i cili jo vetëm është fokusuar në zhvillimin e aktivitetit akademik, por edhe në rritjen e cilësisë së tij.

Institucioni ka hartuar një strategji të ndërkombëtarizimit. Vetëm në xhiron e 2 vjetëve kemi realizuar së bashku me stafin rreth 200 marrëveshje bashkëpunimi me gjithë Europën deri në Amerikë. Falë kësaj strategjie sot kemi një numër të pafund mobilitetesh të stafit dhe të studentëve të të gjitha universiteteve europiane. Këto projekte vlejnë edhe për vitin akademik 2017-2018, duke mundësuar mobilitetin e mbi 100 studentëve në të gjitha ciklet e studimit për një periudhë 6-mujore, projektet Rapsus. Pjesë e mobiliteteve kanë qenë edhe shkëmbimi i mbi 100 stafeve akademike *training and teaching* në universitetet europiane homologe dhe e njëjta gjë ka ndodhur, pasi i gjithë ky numër është rikthyer nga universitetet përkatëse në universitetin tonë.

Një fokus i veçantë në projektet ndërkombëtare është kërkimi shkencor dhe kurrikula, e cila pasurohet falë projekte për ngritjen e kapaciteteve. Aktualisht, jemi duke zhvilluar katër projekte të tilla në fushën e edukimit, të shkencave sociale, të ekonomisë dhe ligjit. Gjithashtu, Universiteti i Elbasanit i ka pritur të gjithë përfaqësitë diplomatike në vend, të cilat kanë organizuar projekte dhe aktivitete me fokus të veçantë “Studenti dhe kërkimi shkencor”.

Stafit akademik të këtij universiteti i janë bashkuar edhe profesorë dhe studiues nga Europa, Shtetet e Bashkuara, Departamenti Amerikan i Shtetit në cilësinë e profesorëve të ftuar. Këto janë shembuj të cilësisë dhe të zhvillimit, i cili vjen si pasojë e bashkëpunimit.

Duke ju uruar punë të mbarë në këtë dëgjese, fjalën po ia jap zonjës Vasilika Hysi, për të vazhduar më tej.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

Vasilika Hysi – Përshëndetje!

Faleminderit, zoti Topi!

Në fakt, është kënaqësi që Universiteti i Elbasanit është universiteti i parë që është përfshirë në konsultimin publik pas miratimit të marrëveshjes së përbashkët që Kuvendi i Shqipërisë ka nënshkruar me 23 universitete. Sikurse e tha edhe profesori është një kënaqësi që më së fundi marrëdhëniet midis Kuvendit të Shqipërisë dhe botës akademike, pedagogëve dhe studentëve tashmë janë të institucionalizuara. Kjo është një ndër nismat që ne po diskutojmë sa i takon konsultimit publik, nismë e kolegëve deputetë të opozitës, lidhur me disa amendamente kushtetuese që përfshijnë vlerësimin e lidhjeve me krimin të organizuar të zyrtarëve të lartë, por ndoshta duhet të ishte edhe një nismë tjetër, pse jo. Sikurse jua thashë, marrëveshja që kemi nënshkruar me universitetet parashikon mundësi shumë të mëdha, në radhë të parë, për

pedagogët, por mbi të gjitha për studentët, për studentët e masterit, të programit të doktoraturës, por edhe për studentët që kërkojnë të bëjnë stazh për të kontribuar në rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të tyre.

Kam kënaqësi që edhe në emër të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë t'ju falënderoj për gjithë angazhimin që keni treguar lidhur me nënshkrimin e marrëveshjes, si dhe ju ftoj që nga dita e sotme e në vijim të bashkëpunojmë jo vetëm në seancat e konsultimit publik, por të shprehni mendimet dhe opinionet tuaja për projektligje të ndryshme, për t'u dëgjuar dhe për t'u angazhuar në studime dhe kërkime shkencore, pse jo kështu siç jeni për të vizituar Kuvendin dhe për të bashkëbiseduar edhe në mjediset e Kuvendit të Shqipërisë.

Sot, Këshilli i Legjislacionit dhe Komisioni i Ligjeve janë së bashku, pasi Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit kërkon që kur ka propozime për ndryshime kushtetuese duhet të ketë një konsultim të gjerë publik. Konsultimi i gjerë publik bazohet në një kalendar të miratuar nga Këshilli i Legjislacionit dhe Komisioni i Ligjeve së bashku. Rregulli është që publiku duhet të njihet me çdo lloj iniciative që depozitohet për ndryshimet kushtetuese dhe duhet të debatohet. Për informacionin tuaj, ne kemi bërë një sërë seancash publike në Kuvendin e Shqipërisë, duke nisur me profesorët ose institucionalistët, punonjësit e praktikës, profesorë të universiteteve në Tiranë. Në kuadër të kalendarit të miratuar nga të dyja komisionet, nga Këshilli dhe nga Komisioni i Ligjeve janë lënë një sërë seancash dëgjimore jashtë Tiranës, sepse ne mendojmë, sikurse e tha edhe me të drejtë rektori i universitetit, që studentët dhe kapacitetin e profesoratit ne nuk e kemi vetëm në universitetet e Tiranës, por kemi burime njerëzore shumë të mira dhe të përgatitura në të gjitha universitetet e vendit.

Po e nisim me qytetin e Elbasanit për ta vazhduar më tej me Vlorën dhe Shkodrën, ndërkohë që ditën e hënë Kuvendi i Shqipërisë pret delegacionin e Komisionit të Venecias. Komisioni i Venecias e ka vlerësuar faktin që ne po bëjmë një konsultim të gjerë publik, si dhe vetë ata po organizojnë një seancë konsultimi publik me qëllim që opinioni që do të vijë në mes të muajit dhjetor, i cili do të jetë opinioni përfundimtar, të jetë i bazuar në seancat e diskutimit dhe të debatit, jo thjesht në opinionin e ekspertëve.

Nga ana tjetër vlerësojmë se është respekt për nismën që depozitojnë kolegët, qoftë ata të maxhorancës apo të opozitës për t'u diskutuar dhe për t'ua bërë të njohur jo vetëm grupit të deputetëve që janë të pranishëm dhe që përbëjnë Këshillin e Legjislacionit dhe Komisionin e Ligjeve, por kujtdo tjetër, sepse ka të bëjë me aksesin e publikut në vendimarrje, por më tepër

Kuvendi i Shqipërisë e ka detyrim edhe në kuadër të strategjisë të komunikimit dhe të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje. Këtu së bashku me mua me kolegët e Komisionit të Ligjeve dhe të Këshillit të Mandateve janë të pranishëm edhe këshilltarë të Kuvendit të Shqipërisë, të cilëve në përfundim të këtij takimi ju mund t'u merrni informacione, të shkëmbeni mendime se si mund të rritet dhe të fillojë zbatimi i marrëveshjes që ne kemi nënshkruar, për të mos humbur kohë.

Sapo të mbërrijë opinionin e Komisionit të Venecias të gjitha grupet, të cilat janë konsultuar, do të përfitojnë opinionin në variantin shqip dhe anglisht, të cilin ne do ta dërgojmë zyrtarisht nëpërmjet kanaleve zyrtare për t'ua bërë të ditur të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në seancat dëgjimore dhe kanë kontribuar me opinionet dhe mendimet e tyre.

Do të doja t'ju falënderoja, si dhe të ndihemi të lirshëm për t'u shprehur në lidhje me draftin që ne kemi përcjellë për opinionin dhe mendimet tuaja.

Faleminderit pedagogëve, por në mënyrë të veçantë studentëve, të cilët janë të pranishëm sot në këtë orë të mesdrekës.

Faleminderit!

Luçiano Boçi – Përshëndetje të gjithëve!

Për mua është një kënaqësi e veçantë që rikthehem në Universitetin e Elbasanit. Në fakt, për t'i vazhduar seancat dëgjimore sipas përcaktimit që ka dhënë kreu i Kuvendit në lidhje me ankimet kushtetuese të propozuara nga Partia Demokratike për t'i hapur rrugën e vetingut në politikë, fjala “veting politik” duhej përmendur gjatë fjalës që mbajti drejtuesja. Ky është qëllimi kryesor. Çështja nëse është seancë dëgjimore apo konsultim publik, kjo është thjesht procedurë dhe nuk dua të ndalem këtu, por dua t'ju rithem atë që kemi deklaruar, çështja e pranimin të vetingut në politikë është çështje e vullnetit politik, një çështje që ose pranohet, ose nuk pranohet. Pra, nuk është e nevojshme futja në kalenda të tilla diskutimi pa fund në formë pelegrinazhesh.

Komisioni dhe këshilli nuk po bëjnë asgjë tjetër, por vetëm një lloj pelegrinazhi televiziv, të cilin kërkojnë ta paraqesin si një angazhim total, por në fakt, është një pelegrinazh, sepse zakonisht pelegrinazhi është për të ngjallur mitet, për të varrosur vetingun politik. Është parathënë dhe është deklaruar nga vetë Kryeministri që veting në politikë nuk do të ketë. Pra, pavarësisht opinionëve që do të jepni ju, jam i nderuar për opinionet tuaja, si dhe për opinionin e Komisionit të Venecias, i cili do të vijë në datën 19, siç u tha këtu, por vendimi është marrë nga

mënyra se si është ndërtuar, pasi flitet për konsultim publik, por mendimi i publikut hidhet në kosh.

Pyetja që unë kam është shumë e thjeshtë dhe lidhet me çështjen më sensitive: pse nuk është thirrur Universiteti i Elbasanit, bota akademike? Pse mungon konsultimi publik? Për çfarë? Për ligjin më të rëndësishëm që është buxheti i shtetit, sa herë është thirrur Fakulteti i Ekonomisë i këtij universiteti dhe bota akademike? Asnjë herë.

Partia Demokratike mendon se këtu nuk ka fare nevojë për diskutim publik, por ka nevojë për vullnet politik, ndërsa këtu vetëm bëhet shou dhe me forma të tilla, të cilat nuk janë efektive. Madje, mendimi i botës akademike duhet të ishte ai që prin zhvillimin ekonomik të një vendi, gjë që nuk ka ndodhur asnjëherë. Gjithsesi, mirë se vini në Elbasan! Unë jam nga ky qytet dhe më takon përtej fjalëve të ashpra që do ju them, t'ju shpreh edhe mirëseardhjen!

Të vish në Elbasan është një gjest dhe gjesti shërben më shumë sesa fjala. Elbasani ulëret për vetëingun politik, mjafton që ju jeni të pranishëm, i cili, në fakt, është argument kundër jush, sepse të vish këtu është argument i shtuar që vetëingu politik duhet, sepse është rikthim në vendin e krimit. Pse? Sepse krimi i votës në Elbasan ka qenë më ulëritës përgjatë fushatave elektorale, gjë të cilën e kemi përjetuar vetë, ku simbioza e politikës, e krimit thërret dhe për këtë arsye kërkohet ai vetëingu politik. Akuzat tona kanë qenë të qarta edhe për kreun e grupit parlamentar, edhe për çështjen “Rrahja”, sikurse janë bërë shumë të qarta edhe nga dalja në dritë e përgjimeve të kryebashkiakut të Durrësit, zotit Dako.

Për këtë arsye ne kërkojmë vetëingu politik, sepse këto janë argumente të shtuara se përse duhet vetëingu politik dhe pse vetëingu në drejtësi nuk e plotëson dot vetëingun në politik. Këtë gjë e kam thënë dhe them, është vetë sistemi politik ai që i prodhon të gjitha kolonat e tjera të shtetit, edhe sistemin e drejtësisë. Një politikë e kriminalizuar normal që do të sjellë ekzekutiv të kriminalizuar, siç e kemi, parlament të kriminalizuar, siç e kemi vërtetuar, por sigurisht edhe kapjen e drejtësisë, siç po vërtetohet. Dalja e përgjimeve, meqenëse sot janë të pranishëm edhe përfaqësues nga prokuroria, duhej që Dakon ta kishte dërguar në burg, por jo, Dako mbrohet politikisht, sepse reforma në drejtësi e ka kapur drejtësinë dhe nuk vepron për politikanët dhe për këtë arsye ju them që është rikthim në vendin e krimit.

Ka edhe një kuptim tjetër rikthimi në vendin e krimit. Këtu është bota e studentëve, e të rinjve, me të cilën kemi kontakt, por ama krimi ndaj studentëve është krimi që vlen shumë pak. 70% e tyre duan të ikin nga ky vend. Pra, është kjo politikë e mbrapshtë e prevalimit të krimit

para rinisë, para vizionit që ka sjellë këtë situatë, dhe Universiteti i Elbasanit është ai që e vuan më shumë sesa gjithë universitetet e tjera këtë gjendje të braktisjes të Shqipërisë nga të rinjtë. Ne e dimë shumë mirë se si është situata, prandaj këto masa ndaj universiteteve nuk duhet të jenë thjesht aureola duartrokitjesh dhe fjalësh të bukura, por duhet të jenë konkrete. Çdo gjë nis te vota e lirë, e famshme, që të jetë e drejtë dhe e ndershme, jo e ndikuar nga krimi dhe e blerë prej tij.

Ka një absurditet shumë të madh pasi ju si maxhorancë refuzoni vetingun politik, ndërkohë që trupës akademike, e cila për fatin tonë të keq nuk është e shumtë në numër me prezencën e saj, i keni nxjerrë përpara vetingun akademik, apo jo, e keni lançuar me bujë. Pse duhet që këta njerëz që janë këtu të hyjnë në veting akademik dhe pse duhet që politika të marrë përsipër që të mos pranojë vetingun e vetvetes? Tek e fundit, një akademik, një pedagog mund të akuzohet për trafik librash, i cili, sado ta parashtrijmë ne nga ana emocionale, përsëri mbetet një fjalë shumë e bukur, pavarësisht se edhe ajo përfaqëson një vepër penale dhe është e papranueshme për pedagogët, jam dakord, ejani ta bëjmë atë pjesë të nxjerrjes në dritë të veprave të vërteta shkencore dhe titujve të vërtetë. Pse këta njerëz duhet t'i nënshtrohen vetingut, ndërkohë që politika nuk pranon vetingun? Pse kur ju vendosët të bëni veting për pedagogët, nuk morët mendimin atyre? Nuk i dini kushtet e vështira me të cilat punojnë, botojnë, kërkojnë, nuk u morët mendim për të ardhurat mizerabël që kanë dhe në raport me këtë gjykon edhe punën shkencore, por i fusni menjëherë në një filtër në komisione që do të jenë politike, sepse burojnë nga ministria politike dhe nuk do të jenë trupa kolegjiale akademikësh. Sot vini me karshillëk e u thoni – “Po, ju do të hyni në veting akademik dhe nuk e dini ende nëse do të jeni profesorë të asociuar, kurse ne do të jemi në parlament dhe në krye të vendit edhe pse nuk kemi bërë trafik librash, por kemi bërë trafik votash dhe kemi bashkëpunuar me krimin për rrëmbimin e votës”. Ku është drejtësia dhe ku është raporti midis politikës dhe botës akademike? Keni ardhur këtu t'u qani hallet? Ju i qani hallet vetëm me krimin! Është deklaruar tashmë. I qani hallet me ta dhe po me ata i merrni vendimet. Votat i numëroni me ta, pushtetin e ndani me ta, ndërsa bota akademike është ai topi që gjuhet në rrjetë, sa herë është e nevojshme të merren dhe rrëmbehen vota nga ndikimi, reputacioni, fusha e veprimit që ka bota akademike, me të cilën ka kontakt e gjithë shoqëria shqiptare.

Ndaj ne themi se këto dëgjesa janë mënyra përdorimi të botës akademike dhe më vjen keq që bota akademike përdoret, nuk është në dorën e saj ta bëjë apo jo, është një bindje që

kushdo nga ne do ta kishte bërë, por është pozicioni i politikës që imponon botën akademike të bëhet pjesë e lojës së pistë.

Ne kemi një propozim të pastër politik për veten tonë, jo për botën akademike: duam të skanohejmë, të mos kemi lidhje me krimin, që unë apo dikush tjetër të mos i marrim votat nëpërmjet tentakulave të krimit dhe shitblerjes së votës. Ne duam të ndërtojmë Shqipërinë, që të gjithë ne e themi në auditore me studentët tanë, se na e kërkojnë për të na vënë para përgjegjësisë, Shqipëri të drejtë, të ndershme. Ndershmëria dhe drejtësia nis te vota, te politikani, te simbioza e krimit me politikën, që sot drejton këtë vend, fatkeqësisht.

Të nderuar pjesëmarrës në këtë panel,

Të nderuar deputetë të maxhorancës,

Propozimi im është që t'i jepni fund këtij teatri, se këtu jemi në bibliotekë dhe sado bukur t'i luash këtu teatrot, nuk shkojnë. Është salla më e papërshtatshme. Ndoshta në sallën e Kuvendit, teatri ju shkon, por këtu jo!

Më vjen keq që duhet të largohem, më vjen keq për kolegët e mi, sepse bashkë do të kemi momente për t'u takuar!

Faleminderit!

Skënder Topi - Një replikë me drejtorin mund ta dëgjosh!

(Diskutim pa mikrofon)

E bërë politikë, por këtu nuk ka politikë. Edhe atë politikë që bërë, e bërë vet, megjithatë ky është problemi yt. Në demokraci ne themi se fjalën ua japim të gjithëve dhe të tjerët flasin, por kërkohet moderim.

Më vjen keq për profesorin tonë të nderuar që erdhi e bëri politikë! Asnjë nga kolegët deri në këto momente nuk ka bërë politikë, por po bëjmë një dëgjuesë, një diskutim dhe bashkëpunim.

Ia jap fjalën zonjës Hysi, që të vazhdojmë më tej.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Ju kërkojmë shumë ndjesë, flas në emër të Kuvendit të Shqipërisë, pasi zoti Boçi është kolegu im dhe i kolegëve të tjerë! Ne kemi ardhur këtu për një seancë dëgjimore. Është detyrim kushtetues të dëgjoheni, sikurse keni të drejtë të dëgjoheni edhe për shumë çështje të tjera, për të cilat ne kemi finalizuar një javë më parë edhe marrëveshje.

Për të mos humbur kohë, pasi edhe ora nuk është e përshtatshme për ju, do të donim të operonin në këtë mënyrë: në qoftë se ju do të ishit vetë aktorë, do të donim të dëgjonim mendimet tuaja për të gjithë ata që e kanë lexuar projektligjin, nëse kanë mendime, sugjerime konkrete. Ndërkohë, nëse do të keni ndonjë pyetje, për fat, kolegu i opozitës që është propozuesi, nuk ndodhet këtu, unë jam në cilësinë e nënkryetares së Kuvendit, që drejtoj mbledhjen e përbashkët të Këshillit të Legjislacionit dhe Komisionit të Ligjeve, por njëkohësisht mendoj se ne mund të marrim pyetje dhe t'ju përgjigjemi për aq sa na është bërë e qartë, sepse edhe ne kolegët e maxhorancës nuk e kemi të qartë objektivin se çfarë kërkohet realisht me këtë nismë. Është kjo arsyeja që Komisioni i Venecias po bën seanca dëgjimore.

Po ia kaloj fjalën zotit Arbër Gjetaj.

Arbër Gjetaj – Quhem Arbër Gjetaj dhe jam pedagog në Departamentin e së Drejtës.

Ju falënderoj që ma dhatë fjalën!

Projektligjin e kemi para syve dhe e shikojmë, por do të isha i mendimit që ju të vinit përsëri në Elbasan pasi të kemi një vlerësim nga Komisioni i Venecias, që është edhe më profesional.

Unë realisht nuk jam pedagog i së Drejtës Kushtetuese, por shoh që në këtë projektligj kalohet në situatën meta-juridike. Një gjë është Kushtetuta, që është ligji bazë themelor i shtetit, dhe gjë tjetër është të kalojmë pastaj në pjesën e moralit dhe si do ta zbërthejmë për politikën më tutje. Për projektligjin nuk mund të flas sot më shumë se kaq, doja të shikoja jo vetëm këtë relacionin shoqëruar të projektligjit, i cili është një dokument që shtrohet më shumë në rrafshin politik sesa juridik, dhe, për sa kohë ne jemi juristë e për sa na keni thirrur të na dëgjoni, do të donim një mendim më të kualifikuar juridik. Ky është gjykimi im. Do t'ju sugjeroja të vini të na dëgjoni përsëri, pasi të merrni një mendim nga Komisioni i Venecias, pasi gjykoj se janë profesorët më të mirë të së Drejtës Kushtetuese në rang evropian.

Pa dashur të bëj politikë, por realisht unë jam kundër këtij fakti, e di që Kushtetuta është rregull morali, por të hyjmë në detaje kaq të thelluara për të parë moralin dhe integritetin e çdo personi, marr vetëm një rast: “Kontakti me persona të përfshirë në krimin e organizuar”. Ku e di unë cilat janë këto kontakte? Unë jam jurist, mendoj dhe gjykoj si i tillë, pa dalë në aspektin, le të themi, e moralit dhe shpresoj dhe gjykoj se ju si Kuvend, propozimin e vlerësoj, i cili vjen i firmosur prej 44 deputetëve të opozitës, por edhe ju si grup parlamentar të mbanit qëndrimin tuaj

dhe pastaj një mendim më të pjekur mund ta jepnim kur të dëgjojmë Komisionin e Venecias, grupet parlamentare të tjera, dhe pastaj ne si juristë të shprehim vlerësimin tonë.

Ju faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Marinela Muço - Përshëndetje!

Quhem Marinela Muço, studente e vitit të tretë Bachelor, Shkenca Juridike në Biznes.

Profesor Gjeta e ceku pak, unë e lexova me shumë vëmendje projektligjin dhe do të doja t'u drejtohesha përfaqësuesve, propozuesve, zonjave dhe zotërinjve të opozitës për të marrë një përgjigje pasi më lindën pyetje që në fillim për nenin 45, pika 3, për ndryshimet që janë bërë. Duke qenë se marrëdhëniet familjare, profesionale dhe ato sociale askush nga ne nuk mund t'i zgjedhë, por kemi mundësi të zgjedhim vetëm ato shoqërore, përse në nenin 1 nuk është bërë ndarje e rastit për marrëdhëniet familjare dhe ato shoqërore, për kontaktet që kanë me personat e përfshirë në krimin e organizuar? Të jemi realistë, sipas opinionit dhe besimit tim, askush nga ne nuk mund të mbajë përgjegjësi për gabimet që bëjnë familjarët tanë. Ndaj, për ta përmbledhur, si mund ta rishikoni nenin 1 duke mbajtur në konsideratë elementin familjar?

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Në fakt, përgjigjen duhet ta japin propozuesit, pasi kjo është një pyetje që ne e kemi ngritur dhe ia kemi përcjellë edhe Komisionit të Venecias. Meqenëse në nenin 1 kërkohet të përjashtohet nga e drejta për t'u zgjedhur kushdo që ka kryer një krim, por që ka edhe kontakte me shtetas të përfshirë në krimin e organizuar, që mund të jetë, vëllai, daja, xhaja, kushëriri i parë, i tretë, fqinji, mjafton që të kesh kontakt të papërshtatshëm.

o të doja të ishte këtu kolegu Boçi, pasi është një ndër firmëtarët për të na sqaruar, për më tepër që në ligj nuk thuhet qartë se si do të bëhet verifikimi i shmangies së një kontakti, i një telefonateje, bisedeje me dikë, që mund të jetë person që kërkohet, mund të jetë një person në mbikqyrje nga shërbimet inteligjente, mund të jetë një person me precedentë, mund të jetë në hetim e të tjerë. Unë nuk mund të flas më tepër, pasi thuhet se do të përcaktohet me një ligj tjetër, pra me 3/5-at. Nuk është shumë e qartë, ndaj kërkoj ndjesë që nuk mund t'i përgjigjem pyetjes suaj.

Ulsi Manja - Në fakt, unë ju falënderoj për pyetjen!

Kjo është një pyetje, e cila përmban shumë probleme të teknikës legislative, por nuk jemi ne hartuesit dhe propozuesit e kësaj nisme, është Partia Demokratike. Unë nuk e di se çfarë

kanë pasur ndër mend propozuesit në lidhje me kërkesën për ndryshimin e fjalisë së parë në pikën 3 të nenit 45 të Kushtetutës. Shqetësimi është i drejtë.

Në fakt, studentja me pyetjen e saj, për hir të së vërtetës, iu referua thënies që njeriu nuk e zgjedh dot njeriun me gjakun e artë, por rrethin shoqëror e zgjedh deri diku. Kjo pikë e kësaj nisme, që propozon Partia Demokratike, nuk e bën dallimin e kontaktit të papërshtatshëm me personat e afërm, me lidhje gjaku të themi, dhe rrethit shoqëror të subjektit. Prandaj, përtej problemeve të teknikës legjislative që ka nisma, ne i jemi drejtuar Komisionit të Venecias për të marrë një opinion miqësor lidhur me këtë nismë të Partisë Demokratike, sepse vetë opozita, sa herë kemi pasur përplasje politike në lidhje me nisma të caktuara, që ka ndërmarrë Kuvendi i Shqipërisë, vetë lideri i opozitës ka thënë me gojën e tij se kërkon që në këtë proces të përfshihet edhe Komisioni i Venecias, si tabani i demokracisë. Ky ka qenë refreni i opozitës gjatë gjithë procesit të hartimit të reformës në drejtësi. Edhe me nismën e re, për të cilën kemi ardhur sot në universitetin “Aleksandër Xhuvani” për të bashkëbiseduar, kemi ndjekur dy linja:

Së pari, në respektim të Rregullores së Kuvendit kjo nismë po u nënshtrohet të gjitha fazave të konsultimit publik.

Së dyti, ne po presim opinionin e Komisionit të Venecias, i cili na ka konfirmuar zyrtarisht se në datat 19 dhe 20 nëntor, që i bie në fillim të javës tjetër, do të vijë një grup ekspertësh për të bërë një vizitë studimore në Shqipëri, ku do të takohen me deputetët e Kuvendit, me nismëtarët e kësaj nisme, si dhe me autoritet e larta të shtetit shqiptar, me Presidentin, me Kryeministrin, me krerët e grupeve parlamentare, me krerët e opozitës, por edhe përfaqësues të tjerë të përfshirë në këtë proces.

Ne si shumicë e vlerësojmë qëllimin që ka nisma, por na duket e cunguar, sepse vazhdojmë t’i qëndrojmë asaj që kemi thënë, që vetingun më të mirë të klasës politike në Shqipëri dhe të zyrtarëve të lartë të shtetit, të cilët akuzohen për korrupsion apo janë të përfshirë në krimin e organizuar, do ta bëjë SPAK-u dhe BKH-ja, si struktura të posaçme në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Partia Demokratike me këtë nismë, që e ka si refren të saj politik, madje ia ka vërtetuar edhe Komisionit të Venecias, thotë se ne kemi një traditë tashmë të konsoliduar për vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, kemi edhe ligjin që miratuar për vetingun e Policisë së Shtetit, ndaj pse të mos kemi edhe një ligj për vetingun e politikanëve.

Të nderuar profesorë,

Të nderuar studentë,

Personalisht, si kryetar i Komisionit të Ligjeve, por edhe si përfaqësues i kësaj maxhorance, ndaj një mendim krejtësisht të ndryshëm në lidhje me këto pretendime të opozitës. Kostumi i vetingut të gjyqtarëve dhe prokurove, por edhe i punonjësve të Policisë së Shtetit, është i ngushtë për politikanët dhe për zyrtarët e lartë të këtij shteti, sepse, së pari, strukturat e vetingut për gjyqësorin dhe Policinë e Shteti janë struktura të përkohshme dhe janë brenda suazës së një hetimi administrativ, ndërsa ne pretendojmë diçka tjetër për klasën politike dhe zyrtarët e korruptuar të shtetit, kërkojmë hetim penal nga strukturat e posaçme të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, siç është SPAK-u dhe BKH-ja, të cilat, në ligjet e tjera të reformës janë struktura përgjegjëse për të zbatuar jo vetëm Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, por edhe paketën e ligjeve antikorruption, që ne kemi bërë në kuadër të reformës në drejtësi, posaçërisht ligjin antimafia. Çfarë është ligji antimafia?

Në vitin 2017 ne e kemi zgjeruar objektin e këtij ligji, ku përveç organizatës kriminale, bandës së armatosur dhe grupit të strukturuar kriminal, kemi përfshirë edhe veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Gjithashtu, përveçse kemi zgjeruar rrethin familjar, që kanë lidhje me politikanët dhe zyrtarët e lartë të shtetit, ku bëjnë pjesë bashkëshortët, bashkëjetuesit, fëmijët, vëllezërit dhe motrat, ne kemi zgjeruar edhe rrethin e subjekteve të lidhura me zyrtarin e lartë, pra personat fizikë dhe juridikë, me të cilët subjekti ka lidhje të drejtpërdrejtë ose biznesi. Pra, e thënë më qartë: ne, si maxhorancë, po presim opinionin e Komisionit të Venecias, i cili do të jetë një opinion ekspertësh, sepse është organ i specializuar për të dhënë vlerësime në lidhje me ndryshimet Kushtetuese. Ne kurrësi nuk do t'i pranojmë ato ndryshime që tha kolegu im Boçi, sepse Partia Socialiste dhe kjo maxhorancë është për një vendim me themel të politikës shqiptare, por këtë gjë duhet ta bëjë drejtësia dhe jo një komision politikanësh të majtë dhe të djathtë, që të mblidhemi si një komision *add hoc*, me 6 deputetë nga maxhoranca dhe 6 deputetë nga opozita dhe të shpërndajmë certifikata për njëri-tjetrin lidhur me gjendjen politike. Ky nuk është veting dhe më lejoni ta karakterizoj më një shprehje popullore: “Ky është veting maskarallëku”.

Këtu dua ta mbyll, duke falënderuar rektorin e Universitetit të Elbasanit, zotin Topi, stafin akademik dhe të gjithë studentët që janë sot prezent!

Zoti rektor, ju si mikpritës mund të ndiheni të fyer nga fjala e kolegut tim të PD-së, zotit Boçi, por ne jemi mësuar me këto gjëra në parlament, sepse kjo është pjesë e retorikës politike. Ne ndihemi shumë mirë sot në Elbasan, sepse nuk kemi ardhur në Elbasanin e ri, por kemi

ardhur në Elbasanin e traditës, në Elbasanin e mikpritjes, në Elbasanin e tolerancës dhe të bashkëjetesës, në Elbasanin e dijes dhe sot jemi në shtëpinë e tij, në Universitetin e Elbasanit. Ashtu siç e tha edhe kolegja ime Hysi ne kemi shpallur një bashkërendim të institucionalizuar nga Kuvendi i Shqipërisë me bashkimin memorandumit. Rasti i takon që këto nisma për ndryshimet kushtetuese të konsultohen si projektligji i parë i bërë në Universitetin e Elbasanit dhe të jeni të bindur që pas Elbasanit, sipas kalendarit që ne kemi miratuar në Këshillin e Legjislacionit, por edhe në Komisionit e Ligjeve, ne do të vazhdojmë edhe në universitete të tjera të Shqipërisë, sepse memorandumit që kemi nënshkruar këtë radhë është real dhe i kuptimtë.

Edhe një herë ju falënderoj për mikpritjen! Gjithashtu, dua t'ju kërkoj ndjesë në emër të kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, zotit Balla, që është edhe drejtuesi politik në qarkun e Elbasanit, i cili dëshironte të ishte i pranishëm sot në Elbasan, por nuk mund të vinte për arsye se në Tiranë po zhvillohet kongresi i Parlamentit Ndërkombëtar të Tolerancës dhe Paqes. Kështu, ne dhe ju kemi fatin që presidenti i këtij parlamenti është zoti Balla.

I mirëpres kritikën dhe sugjerimet tuaja lidhur me draftin.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Manja!

Po, zotëria.

Shpëtim Hala – Përshëndetje!

Unë quhem Shpëtim Hala dhe jam përfaqësues i studentëve në senatin akademik të universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan.

Fillimisht dua të ndalem te marrëveshja ndërmjet Universitetit të Elbasanit dhe Kuvendit të Shqipërisë. Ne jemi njohur me marrëveshjen në senatin akademik dhe mendojmë se kjo marrëveshje duhet të ishte bërë kohë më parë, por falë punës së rektorit të universitetit, zotit Topi, por edhe të kryetarit të Kuvendit, zotit Ruçi, kjo marrëveshje u realizua. Siç e kam shprehur edhe më parë, unë do të doja që kjo marrëveshje të mos mbetet në letër, por të zbatohet. Zbatimi i saj do të ishte një gjë shumë e mirë, sidomos për studentët, për të shkëmbyer eksperiencën. Pra, do të doja që ne studentët të ishim të pranishëm qoftë në seanca parlamentare, qoftë në komisione të ndryshme të Kuvendit, pse jo të thirremi edhe si palë interesi kur të diskutohen problemet e të rinjve apo çështje të tjera teknike. Universiteti “Aleksandër Xhuvani” nuk i mungojnë kapacitetet akademike, por edhe kapacitetet me studentë, të cilët kanë prezantuar shumë mirë projekte të ndryshme jo vetëm të universitetit tonë, por edhe të Shqipërisë në tërësi.

Lidhur me propozimin e bërë nga opozita, realisht sipas historikut, që nga viti 1998 kur është miratuar Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë deri në momentet që po flasim, janë bërë disa herë ndërhyrje, në mos gaboj duhet të jenë bërë diku te 7 apo 8 ndërhyrje. Për një vend në tranzicion, siç është Shqipëria, kaq shumë ndërhyrje në Kushtetutë do të thotë se ka ende shumë gjëra që duhen bërë. E udhës do të kishte qenë që propozimi i Partisë Demokratike për ndryshimet në Kushtetutë të bëhej në momentin që u miratua ligji për dekriminalizimin, sepse ne po flasim për një fakt që është politika dhe ligji për dekriminalizimin u bë për drejtuesit e lartë të politikës.

Unë dua të mbështes atë që tha edhe profesori, që ne duhet të presim edhe opinionin e Komisioni i Venecias, sepse me këtë projekt që është propozuar për të ndryshuar Kushtetutën ne i mohojmë të drejtën një qytetari për të telefonuar një përfaqësues të zgjedhur nga populli që të kontaktojë me të për çfarëdolloj problemi. Kriminel quhet ai që është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës dhe jo kur ka hamendësime për një person apo për një tjetër nëse ka apo jo lidhje me krimin e organizuar. Pra, për sa kohë që nuk kemi një vendim të formës së prerë të gjykatës, nuk mund ta quajmë një person të lidhur me krimin apo një person që është me precedent penal. Pra, për mua kjo bie ndesh jo vetëm Kushtetutën, por edhe me të drejtat e njeriut.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Dua të bëj një sqarim lidhur me marrëveshjen.

Kjo marrëveshje, nga dita e nënshkrimit të saj, ju ka dhënë mundësinë që jeni të pranishëm në komisione dhe në seanca parlamentare. Gjithashtu, ju ka dhënë të drejtët që të merrni edhe kopje të projektligjeve dhe të shprehni opinionet tuaja me shkrim, me email ose të dëgjoheni.

Ju keni fatin e mirë që ndiqni studimet në një universitet me tradita, sepse nga ky universitet shumë profesorë janë bërë deputetë të çdo partie. Ju keni fatin e mirë që jeni vetëm 20 minuta larg nga Tirana, sepse kjo ju jep mundësinë që të vini në seancat parlamentare shumë shpejt. Fati tjetër juaji është se jeni në vendin e dijes, sepse Universiteti i Elbasanit ka shumë degë studimore dhe kontributi juaj mund të jetë në të gjitha komisionet. Unë kam fatin dhe privilegjin që sot këtu jam me disa kryetarë komisionesh dhe nënkomisionesh shumë të

rëndësishme. Për shembull, një ftesë shumë e mirë do të ishte për t'u bërë pjesë e dëgjësave të reformës zgjedhore dhe këtu kemi bashkëkryetarin, zotin Bledar Çuçi.

Gjithashtu, kemi kolegen Ermonela Felaj, që është kryetarja e Komisionit të Sigurisë Kombëtare, ku mund të angazhohen studentët e Fakultetit të Shkencave Politike dhe Juridike. Ne kemi këtu kolegë deputetë që janë anëtarë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, siç është profesoreshë Kushi dhe shumë kolegë të tjerë. Zëri juaj mund të dëgjohet edhe te buxheti, siç është buxheti i arsimit të lartë, buxheti për qeverisjen vendore, por ju mund të dëgjoheni edhe për rininë dhe për të drejtat e studentëve.

Unë do t'ju inkurajoja fort, sepse të gjithë këtu jemi profesorë, pra para se të futeshin në politikë, kemi qenë pjesë e botës akademike. Këtu i pranishëm është edhe nënkryetari i komisionit që lidhet me çështjet e administratës publike, zoti Hyseni, ndaj ju mund të na adresoheni që të dëgjoheni dhe të shprehni shqetësimet tuaja si do ta donit më mirë administratën publike, si mund të bëhen rekrutimet më mirë qoftë nga DAP-i apo nga institucionet e tjera, si mund të tërheqim studentët e ekselencës që t'i fitojnë ata konkurset dhe të mos i fitojnë ata që nuk e meritojnë apo ata që u përkasin partive politike.

Ndaj, dua t'i inkurajoj në mënyrë të veçantë studentët dhe kjo arsyeja që ne kemi sjellë 3 këshilltarë të parlamentit, ju keni sjellë 4 këshilltarë të parlamentit që merren me komunikimin me publikun. Pra, është shumë e thjeshtë, mjafton një klikim në faqen e Kuvendit dhe mund të gjeni një formular me tre zëra ku mund të shkruani adresën dhe ju jeni të mirëpritur të dëgjoheni në të gjitha komisionet ku ne jemi, në Komisionin e Ligjeve, sigurisht që po, por edhe në komisionet e tjera. Kjo do të ishte një gjë e mirë dhe jeni të mirëpritur që javën tjetër në parlamentin shqiptar.

Por ju mund të sillni edhe studentët e ekselencës, që të bëjmë stazh pranë deputetëve. Unë e di që deputetët e Elbasanit kanë pranuar studentë si stazhierë, që janë shkolluar në Universitetin e Elbasanit dhe i keni ekselentë. Pra, studentët kanë nevojë që të mbështeten dhe të inkurajohen që t'u hiqet frika se ndoshta nuk dinë, sepse janë shumë të mirë.

Unë kam një studente si stazhiere, e cila studion në Tiranë, por nuk është nga Tirana dhe është e mrekullueshme. Pra, të gjithë studentët, sidomos të nivelit master do të ishin të mirëpritur për të punuar si asistentë të deputetëve, cilado të jetë bindja e tyre politike, e majtë, e djathtë, e LSI-së, PDIU-së e të tjerë, pra të çdo krahu politik, sepse nuk i pyesim studentët për bindjet që kanë.

Unë nuk e di se çfarë bindjesh ka vajza që punon me mua. Ajo punon me mua në zyrë, me ndjek në aktivitete, në Kuvend punon për projektligje, oponenca, por akoma nuk ka hyrë te pjesa e fjalimeve dhe e diskutimeve, pra merret me çdo gjë përveç politikës, sepse unë nuk e di se çfarë bindjesh ka dhe nuk mund ta angazhoj në zona elektorale. Mendoj që kjo është një praktikë shumë e mirë dhe këtë gjë mund ta bëjmë me të gjithë studentët, duke filluar me ata të ekselencës, profesor Topi. Ne kemi 8 komisione të përhershme dhe nuk janë pak, si: Komisioni i Shëndetësisë, i Edukimit, i Veprimtarisë Prodhuese, i Ligjeve, i Politikës së Jashtme, i Integritetit dhe të tjera. Pra, çdo student mund të gjejë veten e vet, sepse mund të kemi studentë që janë të shkëlqyer në çështje të integritetit evropian ose për ekonomi financë. Kjo do të ishte gjëja më e mirë.

Nga ana tjetër, meqenëse e përmendi senatori, unë jam shumë dakord me oponencën dhe jua premtova që sapo të mbërrijë opinioni përfundimtar i Komisionit të Venecies ju do të merrni variantin zyrtar në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Unë mendoj që kjo është në respekt të kësaj seance dëgjimore, për fat marrëveshja filloi të zbatohet në Elbasan, por edhe për të dhënë një informacion më shumë dhe për të pasur një mendim shumë profesional të 5 ekspertëve. Komisioni i Venecies ka rreth 47 ekspertë në përbërjen e tij dhe opinioni do të jetë si ai që ne pedagogët përdorim në leksionet tona.

Fjalën mund t'ia japim atij djalit.

Spiro Maliqi– Faleminderit të gjithëve!

Unë kisha një replikë ndaj zotit Boçi, i cili është një ndër firmëtarët e projektligjit që kemi përballë, por duket që nuk i preferon debatet parlamentare dhe debatet nëpër salla dhe këtë nuk e di përse, por gjithsesi shpresoj që mesazhi të përçohet nga kolegët.

Janë dy gjëra me projektligjin. E para, ashtu siç tha edhe zoti Manja, me reformën në drejtësi, e firmosur përpara dy vjetësh edhe nga vetë anëtarët e Partisë Demokratike, parashikohet të ngrihen organe të posaçme si SPAK-u, i cili është filtrues, por kjo më duket pak e ekzagjeruar në kuadër të projektligjit që të ketë një organ tjetër *add-hoc* mes deputetëve për të kundërshtuar karrierën e një deputeti tjetër.

Diçka tjetër që është më formale, më duket e pavend dhe pa etikë në mungesë të një akordi për projektligjin, ku Partia Demokratike që ka firmosur projektligjin të mos paraqitet në parlament, sepse në përshtypjen time krijon një precedent të rrezikshëm mes situatës politike në

Shqipëri, që ndizet shumë kollaj. Pra, mjafton që të mos biesh dakord në një projektligj dhe ti nuk duhet të shkosh në parlament. Kjo për mua është e papranueshme.

Faleminderit!

Arsen Berisha – Jam pedagog i së Drejtës në Fakultetin e Ekonomik dhe dua të ndaj diskursin politik me atë juridik.

Personalisht mendoj që vetingu në politikë është një iniciativë e mirë, por rruga e zgjedhur është e gabuar, sepse mjafton që partitë politike të kenë vullnet që këto norma të filtrimit dhe çdo formë tjetër t’i fusin në statutet e partive. Pra, duke filluar vetingun në politikë, në arsim, në biznes, në polici e të tjera, po e zhveshin funksionin e prokurorisë nga funksionet bazë dhe kam frikë se prokurorët do të ndihen xheloz në këtë aspekt. Në përkufizimin aktual thuhet: “Personat që kanë kontakt me personat e përfshirë”. Po kush do t’i verifikojë këto kontakte? Pra, ekziston rreziku i dublimit të organeve kushtetuese dhe ligjore. Në këtë aspekt duhet bërë ndërgjegjësimi i politikanëve dhe kryesisht i kryetarëve të partive, sepse ne dimë se si funksionon sistemi zgjedhor në bazë të listave propocionale rajonale. Pra, në momentin që partitë politike do të zgjedhin përfaqësuesit e tyre, të bëjnë filtrimin sipas rregullave të tyre dhe programet politike t’i paraqesin me këto përfaqësues të popullit dhe pastaj është populli ai që voton. Ndryshimi i Kushtetutës sa herë që neve na kujtohet ndonjë gjë dhe sa herë që del një perspektivë tjetër, unë mendoj se është gabim. Praktika e ka treguar se sa herë që kemi ndryshuar Kushtetutën, qëllimi ka qenë i mirë, por nga ana tjetër e kemi cunguar atë më shumë.

Faleminderit!

Xheni Sallja – Jam studente në Fakultetin Ekonomik. Duke lexuar këtë projektligj vërej që në shtesën që është bërë në pjesën 16/1, në lidhje me kontrollin e figurës, te pika 2 ju keni cituar një parim që vjen nga Konventa e të Drejtave Ndërkombëtare e Njeriut, për një proces të rregullt ligjor dhe për të drejtat themelore. Por si parashikohet dhe si bëhet ky garantim i këtij procesi të rregullt? A do të jetë ky një proces analog edhe për sistemin në drejtësi?

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, Denisa për pyetjen, por ne nuk jemi në gjendje të përgjigjemi, sepse projekti nuk sjell asnjë informacion të detajuar se si do të bëhet, kush do ta bëjë, nëse do të respektohen rregullat e procedimit përpara provës e të tjera. Ne e kemi bërë këtë pyetje dhe nuk kemi pasur mundësi të marrim një përgjigje, prandaj ju kërkoj ndjesë.

Klajdi Muça – Dua të di se si parashikohet *(nuk dëgjohet)* për të garantuar mirëfunksionimin e sistemit të reformës në drejtësi. Pra, si do të veprohet me bazën kushtetuese në Gjykatën e Lartë, e cila nuk është në funksion në këto momente?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Ju falënderoj për pyetjet!

Ju bëj të ditur juve dhe opinionit publik atë shqetësim që është për ngritjen e organeve të reja të sistemit të drejtësisë. Këtu kam fjalën për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Kur do të plotësohet numri i nevojshëm i anëtarëve sipas Kushtetutës dhe ligjit? Kur do të kemi Gjykatë Kushtetuese dhe kur do të kemi SPAK? Nëse e kemi parasysh se kur filloi procesi i vetingut dhe kur është dhënë vendimi i parë nga organet e vetingut, ka qenë marsi i vitit 2018 dhe deri më sot organet e vetingut kanë dhënë rreth 69 vendime, të cilat i janë referuar listës prioritare të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Më lejoni të them që refoma në sistemin e drejtësisë, sipas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjeve bazë të refomës është konceptuar tërësisht në sistemin *(nuk dëgjohet)* që do të thotë që ventingu është forma më e mirë për nga ecuria e procesit, e cila do të zhbllokojë të gjitha institucionet e reja të sistemit të drejtësisë. Sot pas vendimit të listës së parë prioritare, unë mund ta them që jemi shumë afër dhe ndoshta brenda këtij viti do të ngremë Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Me ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor do të hapet rruga e plotësimit me numrin e nevojshëm të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, sepse me reformën e re në drejtësi Gjykata e Lartë është pjesë e karrierës në gjyqësor dhe emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë e bën Këshilli i Lartë Gjyqësor. Pra, Gjykata e Lartë me reformën e re në sistemin e drejtësisë është e distancuar dhe baraslarguar nga politika.

Me ngritjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor do të kemi gjykatën e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe do të zgjedhim dhe Prokurorin e Përgjithshëm sipas procedurave dhe standardeve që ka përcaktuar Kushtetuta. Brenda dy muajve nga ngritja e Këshillit të Lartë Gjyqësor do të kemi SPAK-un dhe Byronë Kombëtare të Hetimit, si struktura përgjegjëse për të hetuar korrupsionin dhe krimin e organizuar në radhët e zyrtarëve të lartë të shtetit përfshirë politikanë, deputetë dhe ministra, pra duke filluar nga Presidenti dhe deri tek anëtarët e këshillit bashkiak. Pra ky është vetingu i madh i politikës, për të cilin po diskutojmë

dhe që ne e presim të formojë këto dy struktura që ne i kemi konceptuar në kuadër të reformës në drejtësi.

Pyetja kur do të kemi Gjykatë Kushtetuese? Plotësimi i numrit të nevojshëm të anëtarëve në Gjykatën Kushtetuese është i lidhur me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, i cili ka dy funksione: liston anëtarët për në Gjykatën Kushtetuese, që vijnë nga Presidenti i Republikës, Kuvendi i Shqipërisë dhe Gjykata e Lartë dhe liston kandidatët për Inspektoratin e Lartë në Drejtësi.

Sot është data 15 nëntor dhe sipas Kushtetutës dhe ligjit, kryetari i Gjykatës Kushtetuese, kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë kanë dërguar në INSTAT kandidatët për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi te Presidenti i Republikës dhe njëkohësisht kanë vënë në dijeni edhe Kuvendin e Shqipërisë.

Presidenti i Republikës ka detyrimin kushtetues dhe ligjor të hedhë shortin deri në datën 5 dhjetor, për 9 anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Në rast se Presidenti nuk do ta ushtrojë këtë detyrë kushtetuese, Kushtetuta dhe ligji ia kalon këtë të drejtë Kuvendit, i cili mes datave 5 dhe 10 dhjetor do të hedhë shortin për emërimet në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi. Me zgjedhjen e këtyre anëtarëve ne shpresojmë që në fillim të vitit që vjen, duke respektuar të gjitha afatet dhe procedurat që parashikon Kushtetuta dhe ligji, të kemi Gjykatë Kushtetuese brenda tremujorit të vitit që vjen. Por mos harroni që një reformë kaq e thellë në sistemin e drejtësisë, e cila e përmbys tërësisht sistemin e vjetër, që u konceptua në vitin 1992, do t'i kishte këto vështirësi dhe këto pasoja që po vuan sistemi sot. Ne kemi qenë koshientë për këto vështirësi, ndërsa opozita, Partia Demokratike, më lejoni t'ju them se ka bërë gjithçka për ta penguar reformën në sistemin e drejtësisë, sepse siç duket u bë pishman për votën që dha për ndryshimet kushtetuese në mesnatën e 21-22 majit. Pse e them këtë? Nëse Partia Demokratike nuk do ta kishte çuar ligjin e vetëgjyqësorisë në Gjykatën Kushtetuese, ne sot do të kishim Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese, KED-në, SPAK-un dhe...(nuk kuptohet). Do të kishim edhe prokurorin e Përgjithshëm të zgjedhur sipas formulës kushtetuese.

Partia Demokratike vazhdon ta pengojë me çdo mjet zbatimin e plotë të reformës në drejtësi, por falë mënyrës se si është konceptuar reforma në drejtësi, atë nuk e pengon dot politika, as Partia Socialiste, as Partia Demokratike, as Lëvizja Socialiste për Integritet. Nuk e pengon dot më politika, sepse reforma në sistemin e drejtësisë ka hyrë në një proces

automatizimi. Kushtetuta i ka parashikuar të gjitha çelësat e zhbllokimit në rast se politika kërkon ta bllokojë që reformën në sistemin e drejtësisë.

Pse them se opozita nuk e do jetësimin në praktikë të reformës në drejtësi? Në të vetmen mundësi që iu dha në seancën e korrikut, kur u mbyll sesi i janarit, nuk e dha votën për ligjin e Shkollës së Magjistraturës.

Çfarë ishte ai ligj? Ai ligj kërkonte emërimin e 16 magjistratëve që janë diplomuar në korrik të këtij viti, si dhe të hapte procesin e pranimit në programin e formimit fillestar për Shkollën e Magjistraturës, për të plotësuar vakancat që mund të krijohen nga procesi i vetingut. Opozita nuk e dha votën dhe e bllokoi. Por a e ka bllokuar përfundimisht? Jo, sepse në momentin kur në dhjetor do të mbledhet Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, do të zhbllokohet edhe situata në Shkollën e Magjistraturës.

Kjo ishte përgjigjja ime.

Ajo që është shkruar në Kushtetutë dhe në ligjet bazike të reformës do të jetësohet shumë shpejt.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Një studente po ngre dorën, por nuk e di...

Nevila Rabushja – Përsëndetje!

Jam Nevila Rabushja nga shkencat juridike, sektori publik, viti i tretë.

Nuk arrij të kuptoj diçka në nenin 1 të propozimit të ligjit, ku thuhet; “Ndalohen të zgjidhen persona që kanë kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar”.

Nuk arrij ta kuptoj se cila është ajo normë kushtetuese, se cili është ai ligj, që i jep tagrin një deputeti apo një kryetari bashkie të mos kontaktojë me këta persona. Kush është ai deputet apo kryetar bashkie që i thotë një individit se nuk mund të komunikoj me ty, sepse je i përfshirë në krim? Është pushteti gjyqësor ai që ka tagrin të përcaktojë kur një person është kriminel apo kryer një vepër penale. Nuk e ka deputeti këtë tagër.

Faleminderit!

Vasilika Hysi - Në fakt, është një pyetje që duhet t’ua bëjmë kolegëve propozues.

Ka një shqetësim. Shumë herë kam marrë si model rastin tim. Unë jam kryetare e Nënkomisionit të të Drejtave të Njeriut dhe marr shumë telefonata nga burgu. I dënuari ka të drejtë të telefonojë dhe të thotë: “Mua po më shkelen të drejtat dhe kërkoj të vini të monitoroni

këtë burg” ose marrin të gjithë deputetët në telefon. Ata janë edhe zgjedhës... “Po një takim, deputete? Kur do të jesh te zyra e pritjes?” e të tjerë.

Pyetja që ne u ngremë kolegëve është si ta dallojmë në telefon se kush është ai që telefonon, që më thotë se dua të të takoj? Unë e di që një person në burg është i dënuar. Ai mund të jetë dënuar për drogë. Si t’i them unë si kryetare nënkomisioni, që nuk do të vij? Apo nuk do t’i përgjigjem në telefon?

Të jemi të singertë, të gjithë ne deputetët tashmë jemi shumë të shfrenuar. Ndoshta ju mund ta keni ndier... Për deputetët e majtë, të djathtë apo të LSI-së, nuk e di, por ne jemi shumë të kujdesshëm. Ne nuk i përgjigjemi çdo telefonate dhe shpeshherë me njëri-tjetrin themi: “Kush po na telefonon, se nuk po e marrim vesh”?

Kolegëve të huaj, ekspertëve të huaj u kemi thënë: “Si na këshilloni? Si të sillemi? Pati prej tyre që na thanë: “Pse, ju marrin në telefon zgjedhësit?! Pse, ju komunikoni drejtpërdrejt me zgjedhësit kur jeni jashtë fushate”?

Pra, ideja është që ekspertët dhe kolegët tanë, kujtojnë se ne kemi zyrë, kemi sekretare, kemi telefon zyrtar dhe njerëzit telefonojnë nëpërmjet sekretarisë së deputetit, ndërkohë që ne nuk kemi as zyrë, as sekretari, as telefon zyrtar. Ne kemi telefonat tanë personalë, ku mund të na telefonojnë të gjithë.

Në situatën kur ne u themi ekspertëve të huaj se ne kemi lidhje, dalim me miqësi, me nipërit dhe mbesat, ka pasur nga ata që kanë thënë: “Po pse, vijnë rregullisht t’ju takojnë? Vijnë nëpër shtëpi?” Një pjesë e tyre nuk arrijnë ta konceptojnë që në shtëpitë tona ne mund të rrisim edhe djalin e vajzës, nipin apo mbesën. Në logjikën e tyre kjo është e papërshtatshme. Disa prej tyre thoshin: “Shiko, ju duhet të hiqni dorë nga këto gjëra ose duhet të merrni staf teknik, që të përgjigjet stafi dhe të mos përgjigjeni ju, me qëllim që të shmangni merakun që keni”. Por me këtë ligj, asnjë nuk e shmang dot këtë. I bie që ne të zgjedhurit të mos kemi më komunikime me zgjedhësit ose duhet të jemi jetimë, pa nënë, pa baba, pa motër, pa vëlla, pa nipër dhe mbesa, sepse ne nuk e dimë se me çfarë merren ata, se kë kanë shokë e shoqe, se me kë lidhen.

Ulsi, si dibran që është, thotë: “Kur të takojmë dikë në kafe duhet t’i themi: “Na trego pak dëshminë e penaltetit, pastaj do të ulesh në kafe me ne”. Kur ka dëshminë, është mirë, por kur e ndjek SHISH-i dhe shërbimet inteligjente, mund të jetë kontingjent dhe ne nuk dimë gjë. Këtë nuk e shmangim dot, sidomos kur je në takime elektorale, në pritje të popullit, kur je në zonë, kur troket derë më derë e të tjerë.

Janë shumë pikëpyetje, për të cilat uroj që Komsionit i Venecies do të japë përgjigje.

Skënder Topi – Nëse nuk ka pyetje të tjera...

Do të bëj vetëm një koment të vogël. Mirë deputetët, po doktorët që rrinë 24 orë në punë, u bie telefoni dhe i merr një kriminel, një i dënuar... *(Nuk dëgjohet mirë)* Çfarë të bëjnë? Të mos japin përgjigje?

Vasilika Hysi – Nuk keni veting ju.

(Diskutime pa mikrofon)

Skënder Topi – I bie të bëjnë veting edhe nënat tona, që janë 70-80 vjeç. Megjithatë, kjo ishte thjesht për ta... *(nuk kuptohet)* këtë dëgjese.

Ju falënderoj shumë!

Në emrin tuaj, do ta falënderoja edhe Kryetarin e parlamentit! Para 10 ditësh ne firmosëm këtë marrëveshje. Është pak vulgare, por do ta them. Kryetari i Kuvendit, mbasi firmosëm marrëveshjen, iu drejtua medieve: “Jeni mbi 20 medie. Do ta shohim se sa do ta pasqyroni këtë diskutim që po bëjmë sot mes intelektualëve dhe profesorëve të nderuar, sepse jemi mësuar të merremi me njëri-tjetrin me “libër shtëpie” që ju të bëni lajm”.

Këtu po e mbyll...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Shumë pak.

Skënder Topi – Ne jemi këtu sot, edhe parlamenti ashtu duhet të jetë. Madje, ta dinë mirë edhe historinë e politikës, se në parlamentin tonë ne dëgjojmë gjëra të tilla nga të gjitha palët, më shumë nga opozita dhe pozita kur janë në opozitë, që të jemi realistë.

Duhet moderuar gjuha, sepse në familjet tona ka njerëz të sëmurë, ka fëmijë, ka njerëz që nuk kanë nivelin e duhur... Siç ishte edhe rasti i profesorit të nderuar sot. Unë nuk ia hoqa fjalët profesorit, por profesori erdhi bëri politikë. Është miku im më i mirë, ta dini të gjithë. Për sa u përket problemeve të pjesës akademike, unë e mbështes fort atë, por për pjesën tjetër nuk e mbështes, sepse t’i thuash një auditori pelegrinazh, kur ai është vetë pjesë e këtij universiteti... Këtu nuk ka pelegrinë, por ka profesorë të nderuar dhe studentë të nderuar. Nga pyetjet që bëjnë studentët u kënaqa shumë, sepse edhe pse ata janë në studim e sipër, pyetjet ishin të gjitha profesionale, edhe pse unë nuk jam ekspert i fushës.

Hapësirat që na janë dhënë nga parlamenti nuk mbetën në letër. Kjo dëshmohet sot me ardhjen tuaj në universitetin tonë.

Ju falënderoj që kjo iniciativë u mor në Elbasan, sepse e meriton. Elbasani është vendi i dijes, kulturës, tolerancës dhe i gjithë të mirave.

Siç e tha zoti Ulsi, edhe në universitet e tjera do të shkohet. Kjo është gjë shumë e mirë, si dhe hapësira që kemi nga departamenti i së drejtës, nga fakulteti i ekonomisë, me profesoreshë Rezartën, për të marrë kontakte me komisionin, që studentët më të mirë të masterit apo *bachelor*-it të realizojnë praktikën në parlament.

Duke ju falënderuar të gjithëve dhe duke ju uruar suksese, shihemi herën tjetër!